



BASHKIA  
TIRANË

## SHTOJCË

### MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT

Sot më datë 09.03.2020, Njësia e Prokurimit ju bën me dije se:

Autoriteti Kontraktor, në mbështetje të Nenit 42, pika 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut VII, Neni 62, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me nismën e vet, vendosi të bëjë ndryshimet në dokumentat e tenderit përmes hartimit të një Shtojce, pwr procedurwn e prokurimit me objekt: **“Rikonceptimi i kopshtit zoologjik”** me fond limit: **702,223,384.20** (shtatëqind e dy milion e dyqind e njëzet e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, miratuar me VKB Nr. 157, datë 26.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2020 – 2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”.

Kjo shtojcw u komunikohet menjëherë të gjithë Operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik duke u bërë detyruese për ta.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, vendosi të bëjë ndryshimet përkatëse në Dokumentat Standarte të Tenderit për procedurën e prokurimit me objekt **“Rikonceptimi i kopshtit zoologjik”** si më poshtë vijon:

Në pjesën Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 5:

#### ISHTE:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensen e shoqërisë ose pajisur me licensë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Ndërtimi, profili infrastrukture
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 2 (dy) inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 1 (një) inxhinier Agrar me profil bimor/ Hortikulturë
- 1 (një) inxhinier Gjeolog
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Arkitekt
- 1 (një) inxhinier Agronom

## BËHET

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar 1 (një) Agronom të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit dhe staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë ose pajisur me licencë individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Ndërtimi, profili infrastrukture
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 2 (dy) inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 1 (një) inxhinier Gjeolog
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Arkitekt

Duke përfshirë zgjatjen e afatit si rezultat i pezullimit për shqyrtim ankesw dhe ndryshimit të dokumentave të tenderit afati kohor për dorëzimin e ofertave zgjatet me 5 (pesë) ditë kalendarike në total. Njësia e Prokurimit njofton të gjithë Operatorët ekonomik pjesëmarrës se afati kohor për dorëzimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonceptimi i kopshtit zoologjik”** është si më poshtë vijon:

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 25.03.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

**Data: 25.03.2020, Ora: 11:00**

**Vendi: Në faqen zyrtare të Web-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**